

Studimet post-diplomatike Master
Programi Ndërkombëtar

Kandidati: Arbnora Bahtijari

Mentor: Prof. Dr. Hajredin Kuçi

Tema: A trajtohet Kosova si shtet i tretë në marrëdhëniet kontraktuale me UE?

Abstrakti

Ky punim synon të shtjelloj marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, si shteti më i ri në kontinent. Analiza juridike e këtyre marrëveshjeve është i një rëndësie të madhe, si për aspiratat e përgjithshme të shoqërisë dhe shtetit të Kosovës për t'u bërë pjesë e kësaj organizate ndërkombëtare, ashtu edhe për zotimin e Unionit se Kosova e ka të ardhmen e saj të sigurt brenda këtij Bashkimi.

Dhe ky proces, siç është parë deri më tani, ka qenë i mbushur me shumë pengesa diplomatike, juridike dhe politike. Sepse, krahas sfidave në aspektin ekonomik ai po shoqërohet nga shumë sfida juridike, për shkak të problemeve politike që i karakterizojnë raportet e Kosovës me Bashkimin Evropian.